



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE/A:	24/04/2018
REFERENC-Ë:	Zyrt. 04-107
PËR/ZA/TO:	Ofertuesit e ekskursionit për maurantët e Gjmnazit “Hajdar Dushi” në Gjakovë
CC:	Gjmnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë
NGA/OD/FROM:	Komisioni selektues
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Njoftim



Njoftohen ofertuesit (agjensitë turistike) të licensuara, të cilat kanë marrur pjesë në ofertim për organizimin e ekskursionit të maurantëve të Gjmnazit “Hajdar Dushi” në Gjakovë në Republikën e Shqipërisë, bazuar në ofertën e shpallur numër të protokollit 1893 të dt.03/04/2018 dhe pas shqyrtimit të ofertave, Komisioni selektues ka marrur Vendim 04 Nr. 106 të dt.24/04/2018.

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 8 ditësh, prej ditës së pranimi të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

Me respekt !



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 106

Më:24/04/2018

Duke u bazuar në UA nr.02/2016 Për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, ofertën me numër protokoll 1893 i dt.03/04/2018 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në Gjimnazin "Hajdar Dushi" në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Vlora, Kruja, Tirana, Fieri dhe qyteti i Durrësit. Ekskursioni zgjat 5 bujtje (pansion i plotë) prej datës 02/05/2018 deri me 07/05/2018.

Lista e konkurrentëve për të fituar ofertën për ekskursion të maturantëve të Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë:

1. "Meti-Comerc-H" me çmim 99.00 €;
2. "Norway Travel" me çmim 90.00 €;
3. "Shpatturs" me çmim 100.00 €;

Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.18/04/2017 në ora 13:30 sipas ofertës nr.1893 i dt.03/04/2018 ku prezent ka qenë përfaqësueset e Drejtorisë së Arsimit znj.Flutur Këpuska, z.Berat Thaqi - Përfaqësues i Këshillit Drejtues të Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë, z.Bedri Cahani – Drejtor i Gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë, znj.Afijete Boshnjaku Haxhikadrija – Zyrtare e Drejtorisë së Arsimit e ftuar në cilësi të vëzhguesit si dhe përfaqësuesit e kompanive konkurruese. Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

Firma transportuese "Meti-Comerc-H" ka konkuruar me çmim prej 99.00€, i njëjti ka ofruar 15 mësimdhënës të liruar nga pagesa dhe sigurimi i shkollës me gjithsejtë 16 persona, dhjetë (10) nxënës që janë në gjendje jo të mirë financiare të cilët janë të përzgjedhur nga Drejtoria e Gjimnazit "H.Dushi", nxënësit janë të liruar nga pagesa gjatë vizitave në monumentet historike në Vlorë dhe Krujë, po ashtu e njëjta firmë merr përsipër edhe bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës. Ka prezantuar menu ushqimi nga Hotel Bonita z.Astrit Ismaili Administrator, ka prezantuar konfirmim rezervimi në Hotel Bonita për datën e akomodimit të grupit dt.02/05/2018 dhe qëndrim deri me dt.07/05/2018, po ashtu ka prezantuar Licencë nga Republika e Shqipërisë – Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës – Qendra Kombëtare e Licencimit. Ka prezantuar Vërtetim

Tatimor nga ana e Administrata Tatimore e Kosovës, Vërtetimin nga ana e Komunës së Gjakovës për obligimet e tatimit në pronë. Ka prezantuar referenca nga shkollat “Emin Duraku”, “Gjon Nikoll Kazazi” dhe “Kadri Kusari” në Gjakovë. Ka prezantuar Certifikatën e Dr. Ilir Grezda si dhe diplomën e shkollës z. Muhamet Nezaj në cilësinë e teknikut medicinal. Ka prezantuar Certifikatën e Regjistrimit, Certifikatën e Numrit Fiskal. Ka paraqitur Autorizimin me nr. 148 i dt. 11/02/2014 nga Republika e Shqipërisë – Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës – Drejtoria e Licencimit – Për transport ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus – lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm Eduart Seitaj. Posedon Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, ka prezantuar 11 autobusa ku 5 prej tyre firma “Meti –Comerc-H” ka marrëveshje me kompanitë tjera transportuese e të pajisur secili prej shoferëve me certifikatë mjekësore.

Firma transportuese “Norway Travel” ka konkuruar me çmim prej 90.00€, i njëjti ka ofruar akomodim në “Hotel Elba” Premium – Shkëmbi i Kavajës – Durrës. E njëjta firmë në aranzhman ka ofruar staf (profesorët) gratis, 10 -12 maturant gratis. Po ashtu ka prezantuar Certifikatën e Regjistrimit, Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, Certifikatë – Deklarues i TVSH-ës, Vërtetimin Tatimor të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, Vërtetimin e obligimit të tatimit në pronë të lëshuar nga Komuna e Gjakovës, Certifikatë të Regjistrimit. Ka prezantuar kontratë në mes të agjensionit turistik “Norway Travel” me përfaqësues ligjor z. Mergim Alija dhe agjensionit turistik “N.T.T Pranvera” me përfaqësues ligjor z. Haki Nimanaj, ka prezantuar Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës për operatorin N.T.T “Pranvera” si dhe Vërtetimin Tatimor të lëshuar nga Administratës Tatimore e Kosovës. Ka prezantuar kontratë në mes të agjensionit turistik “Norway Travel” me përfaqësues ligjor z. Mergim Alija dhe agjensionit turistik “N.T.P Drita” me përfaqësues ligjor z. Hajdar Dili, ka prezantuar Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës për operatorin N.T.P “Dita”, Certifikatën e Regjistrimit si dhe Vërtetimin Tatimor të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Ka prezantuar Kontratë pune në mes të agjensisë turistike “Norway Travel” me përfaqësues ligjor Mergim Alija dhe Dr. Selim Mehmeti – Specialist i Mjekësisë Familjare së bashku me licencën e punës, ka prezantuar kontratë pune në mes të agjensisë turistike “Norway Travel” me përfaqësues ligjor Mergim Alija dhe Selvije Hajdar Mehmeti në pozitën e infermieres si dhe licencën e saj të punës. Ka prezantuar Kontratë Bashkëpunim me Hotel Elba me përfaqësues Henri Demce si dhe përfaqësuesit Mergim Alija, ka prezantuar Leje nga Republika e Shqipërisë – Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes – Qendra Kombëtare e Licencimit, ka prezantuar Certifikatë Regjistrimi të Personit të Tatuësëm nga Qendra Kombëtare e Biznesit - Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ka prezantuar Akt-Miratim Higjieno-Sanitar Nr.3 të lëshuar nga Republika e Shqipërisë – Ministria e Shëndetësisë – Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë – Inspektorati Sanitar Shëndetësor për Hotel “Elba”. Ka prezantuar 3 (tri) fotot të autobusëve dhe 4 (katër) foto të Hotel “Elba”. Ka prezantuar dy (2) referenca njëra nga ana e Parlamentit Studentor si dhe tjetra nga ana e Shkollës “Selman Riza” në Gjakovë.

Ka prezantuar CPC – Diploma - Vërtetimin Tatimor të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe kontratën e punës të znj.Teuta Blyta. Ka prezantuar 11 (njëmbëdhjetë) autobus dhe 11 (njëmbëdhjetë) shoferë të pajisur me certifikata mjekësore.

Firma transportuese “Shpatturs” ka konkuruar me çmim prej 100.00€, vendosja e nxënësve do të bëhet në Kompleksin “Bonita” afër Shkambit të Kavajës, i njëjti ka ofruar që 10 (dhjetë) nxënës të invalidëve të luftës do të jenë gratis ku përzgjedhja e tyre bëhet nga vet shkolla po ashtu mësimdhënësit kujdestarë do të jenë gratis.Ka prezantuar Konfirmim Rezervimi në mes të agjensionit turistik “Shpatturs” dhe Hotel “Bonita” – Administrator Astrit Ismaili. Ka prezantuar Leje nga Republika e Shqipërisë – Ministria e Zhvillimit Ekonomik,Tregtisë dhe Sipërmarrjes – Qendra Kombëtare e Licencimit. Ka prezantuar Licencën D për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të lirë dhe të rregullt të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, ka prezantuar Certifikatën e Regjistrimit, Certifikatë – Deklarues i TVSH-ës, Certifikatë e Numrit Fiskal, Certifikatë të lëshuar nga Republika e Kosovës – Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Dogana e Kosovës të dt.20/08/2010. Ka prezantuar Diplomën e Dr.Baton Lleshi së bashku me licencën e tij të punës si dhe kontratë për shërbim mjekësor në mes të kompanisë dhe z.Lleshi në rast të përzgjedhjes. Posedon Vërtetim nga Komuna e Gjakovës për Shpatturs për taksën në firmë, Vërtetim Tatimor të lëshuar nga ana e Administratës Tatimore e Kosovës. Ka prezantuar 11 (njëmbëdhjetë) shoferë të pajisur me certifikatë mjekësore dhe 12 (dymbëdhjetë) autobus. Ka prezantuar Kontratë për kryerjen e shërbimit të transportit të agjensisë turistike “Shpatturs” me përfaqësues Muhamet Krasniqi dhe agjensisë turistike “Deva Tours” me përfaqësues Avdi Avdija.

Vlerësimi i Komisionit selektues:

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Komisioni selektues ka kërkuar të njoftohen të gjithë prindërit e fëmijëve pjesëmarrës në ekskursion lidhur me ofertat, ku me ç`rast të njëjtit janë ftuar nga mësimdhënësit kujdestarë të klasave dhe takimi është mbajtur në secilën klasë veç e veç. Nga prindërit është kërkuar Pëlqimi për përzgjedhjen e kompanisë për organizimin e ekskursionit, Kërkesës me numër protokolli 1941 të dt.23/04/2018 për organizimin e ekskursionit në Republikën e Shqipërisë për vitin shkollor 2017/2018 me nxënësit maturantë (të klasave të 12-ta), Deklaratës mbi ekskursionin nga ana e Këshillit të Nxënësve të Gjimnazit “Hajdar Dushi” nga ana e Jon Bytyqi në cilësi të Kryetarit të Këshillit të Nxënësve, Procesverbalin e Këshillit të Arsimitarëve me numër të protokollit 1943 i dt.18/04/2018, Planifikimit Vjetor të Drejtorit të Gjimnazit “Hajdar Dushi” në Gjakovë Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë të përzgjedhet firma **“Meti-Comerc-H” me çmim prej 99.00€**

Pas shqyrtimit Komisioni vendosi ta zgjedhë agjencinë turistike **“Meti-Comerc-H” me çmim prej 99.00 €**

Firma “Meti-Comerc-H nga Gjakova

Arsyetim


Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firma konkurruese, Kërkesës me numër protokolli 1941 të dt.23/04/2018 për organizimin e ekskursionit në Republikën e Shqipërisë për vitin shkollor 2017/2018 me nxënësit maturantë (të klasave të 12-ta), Deklaratës mbi ekskursionin nga ana e Këshillit të Nxënësve të Gjimnazit “Hajdar Dushi” nga ana e Jon Bytyqi në cilësi të Kryetarit të Këshillit të Nxënësve, Procesverbalin e Këshillit të Arsimitarëve me numër të protokollit 1943 i dt.18/04/2018, Komisioni selektues jep Vendim që nga ofertat e dorëzuara nga ofertuesit (agjensitë turistike) për Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë të përzgjedhet firma **“Meti-Comerc-H” me çmim prej 99.00€**, pasi firma në fjalë nxënësit janë të liruar nga pagesa gjatë vizitave në monumentet historike në Vlorë dhe Krujë, po ashtu e njëjta firmë merr përsipër edhe bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës.

Komisioni selektues:


1. Flutur Këpuska
(emri dhe mbiemri)


(pozita) dt.23/04/2018

2. Berat Thaqi
(emri dhe mbiemri)


(pozita) dt.23/04/2018

3. Bedri Cahani
(emri dhe mbiemri)


(pozita) dt.23/04/2018

Këshilla juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 8 ditësh, prej ditës së pranimit të së njëjtit. Ankesa i adresohet Sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Agjencive turistike, Sektorit të Inspektoratit të Arsimit në Gjakovë, Shërbimit juridik dhe Arkivit.